



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-103

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR TATIMIN NË
TËARDHURAT E KORPORATAVE Nr. 03/L-162**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR TATIMIN
NË TËARDHURAT E KORPORATAVE Nr. 03/L-162**

Neni 1

Pas nenit 1 të ligjit bazik shtohet nen i ri 1.A me emërtimin dhe përmbajtjen si vijon:

Neni 1.A
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi i normës për pagesën e tatimit për veprimtaritë afariste me të ardhura bruto vjetore deri në pesëdhjetë mijë (50.000) Euro të cilat taten për të ardhurat bruto të realizuara nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit, dhe të ngjashme të çdo tre (3) mujori dhe ndryshimi i procedurës së ankesës.

Neni 2

Neni 2 i ligjit bazik, përkufizimi 1.31. riformulohet si në vijim:

1.31. Ministër – Ministri i Ministrisë për Financa.

Neni 3

1. Neni 35 i ligjit bazik, nën-paragrafi 2.1.2. riformulohet si në vijim:

2.1.2. nëntë përqind (9%) të të ardhurave bruto nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme të çdo tre (3) mujori, por jo më pak se tridhjetë e shtatë pikë pesë (37.5) Euro për tre (3) mujor.

Neni 4

1. Neni 40 i ligjit bazik, paragrafi 2. riformulohet si në vijim:

2. Tatimpaguesi i cili nuk pajtohet me vendimin e Departamentit të Ankesave mund të iniciojë procedurën e ankesës në pajtim me neni 9 të Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat nr. 03/L-222. Procedurat e ankimit duhet të zhvillohen në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin 10, 11 dhe 12 të Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat nr.03/L-222.

2. Neni 40 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet si në vijim:

3. Ndaj vendimit Bordit të Pavarur për Rishqyrtime mund të ushtrohet ankesë në pajtim me procedurat e përcaktuara në nenin 9 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat nr. 03/L-222. Procedura e ankimit do të zhvillohet në pajtim me dispozitat e përcaktuara në nenin 10, 11 dhe 12 të Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat nr. 03/L-222.

Neni 5
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas shpalljes në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-103
3 maj 2012

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI